



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 102 prot.

Kamëz, më 26.07.2024

V E N D I M
Nr. 79 .Datë 26.07 2024
M B I

**“MIRATIMIN E LISTËS SHITESË SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË
SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND
TË PËRBALLOJNË QIRANË PËR VITIN 2024”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.07.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.56 Datë 19.07.2024 Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.112 datë 18.12.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; Vendimit nr.141 datë 25.11.2022 të Këshillit Bashkiak “Për një ndrysim të Vendimit nr. 96 datë 20.11.2023 për Sistemin e Pikëzimit” VKB nr 103 dt.18.12.2023 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2024, 2025, 2026”; Relacionit të Komisionit të Strehimit me nr. Prot 6139 datë 18.07.2024, Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr. 6139/1 Prot datë 18.07.2024, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e trajtimit me subvencion të qirasë për 9 (nëntë) familjet, me vlerë totale mujore 139,047 (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë, e dyzetë e shtatë) Lekë sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë duke filluar nga data 01.08.2024 deri në datën 31.12.2024.
 3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 **do të përballohen 100% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.**
 4. Të ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, si dhe Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatim.
- Bashkëlidhur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

